VENDIM
Nr. 67, datë 27.11.2012

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHTESË NGA BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a", nenit 43 shkronja "e" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 23 pikat 1 dhe 3, nenit 24 pika 1 shkronja "ç" të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe nenit 3 pika 2 të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, të ndryshuar, me propozim të departamentit të mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratim paraprak për kryerjen nga Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

a) shërbim i kasave të sigurimit.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., pas kryerjes së ndryshimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet departamenti i mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet departamenti i marrëdhënieve me jashtë, integrimit europian dhe komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani